

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 4815 Rep.

Nr. 557 Kol. /

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH



Sot më date, 24.12.2018, përpara meje Loriana A. Robo, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë në Tiranë, Rr. "Ismail Qemali", nr. 27/1, u paraqitën palët e mëposhtme për të nënshkruat këtë marrëveshje ("Kontrata"):

Arta Gurabardhi, e lindur në Tiranë, me 20 shtator 1977, me nr. personal në kartë identiteti H75920138M, me adresë email agurabardhi@abkons.com dhe me adresë Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 6, Shk.1, ap.9, Tiranë ("Shitësi");

dhe

Blessed Investment SHPK, me seli në Njësia Bashkiake n.2, Rr. 'Themistokli Gërmenji', përbalë RTSH, K II dhe NIUS L71423028S i përfaqësuar nga Besnik Leskaj, i lindur në Tiranë, me 30 qershor 1976, me nr. personal identifikimi H60630112W, me adresë Bulevardi 'Bajram Curri', Pall 6, shk. 1, ap.10, Tiranë, dhe adresë email leskajb@abkons.com ("Blerësi").

të gjithë madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

(në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala").

Kushtet paraprake

- (A) Në datën e kësaj Kontrate Shitblerje Kuotash, Shitësi dhe Blerësi kanë nënshkruar një marrëveshje kuadër që rregullon marrëdhëniet midis tyre në lidhje me veprimet juridike për kuotat e shoqërive tregtare ku janë aktualisht bashkë-ortakë ("Marrëveshja Kuadër") dhe, ndër të tjera, në shoqérinë Abkons SHPK, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake n. 2, Rr. 'Themistokli Gërmenji', përbalë RTSH, K II, me kapital 100,000 ALL dhe NIUS K61926012O (në vijim "Shoqëria").
- (B) Shitësi është aktualisht pronar i një kuote me vlerë nominale të barabartë me 40,000 ALL ("Kuota Target") që përfaqëson 40% të kapitalit të Shoqërisë;
- (C) Blerësi është aktualisht pronar i një kuote të Shoqërisë me vlerë nominale të barabartë me 50,000 ALL që përfaqëson 50% të kapitalit të saj;
- (D) Në datën 15 maj 2018, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ka miratuar shpërndarjen e dividendit të vitit 2017 në favor të ortakëve, për vitin financiar të mbyllur në 31 dhjetor 2017, dhe, deri pas datës së kësaj kontrate, ndër të tjera, Shoqëria nuk i ka paguar ende Shitësit një pjesë te ketij dividenti të barabartë me Euro 306,483.00 (treqind e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre Euro) ("Dividendi 2017 i papaguar");
- (E) Marrëveshja Kuadër, ndër të tjera, rregullon edhe kalimin e pronësisë së kuotave të shoqërisë Albanian Financial Institution SHPK, me NIUS L52327028M të cilat janë aktualisht në pronësinë e Shitësit ("Kuota AFI Gurabardhi") në favor të Blerësit;
- (F) Shitësi ka si qëllim t'i shesë Blerësit Kuotën Target dhe Blerësi ka si qëllim të blejë Kuotën Target nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim.

Palet, duke marre parasysh sa më sipër, bien dakord si në vijim:

Neni 1
Kushtet paraprake

1.1 Kushtet paraprake të mësipërme dhe kushtet përkatese të Marrvëshjes Kuadër janë pjesë thelbësore dhe integruese e kësaj Kontrate.

Neni 2
Kushtet e Kontratës

- 2.1 Palet bien shprehimisht dakord se detyrimi i Shitesit për t'i transferuar pronësinë e Kuotës Target Blerësit hyn në fuqi vetëm pasi:
- (a) Kuota AFI Gurabardhi të ketë kaluar në pronësinë e Blerësit; dhe
 - (b) Shoqëria t'i ketë paguar Shitesit deri në datën 20 Shkurt 2019 të gjithë shumën e Dividendit 2017 ndaj Arta Gurabardhit.



Neni 3
Transferimi i pronësisë së Kuotës Target

- 3.1 Nëpërmjet kësaj Kontratë dhe në perputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në të, Shitesi i shët dhe i transferon Blerësit i cili, pranon dhe bien, Kuotën Target me një çmim të barabartë me Euro 1,200,000 (një milionë dyqanëmë Euro) (në vijim referuar si "Çmimi").
- 3.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitesit brenda datës 28 shkurt 2019.
- 3.3 Palet bien shprehimisht dakord se titulli i pronësisë mbi Kuotën Target do të transferohet nga Shitesi tek Blerësi në momentin kur Blerësi t'i ketë paguar Shitesit Çmimin e Kuotës i përcaktuar në pikën 3.1 me sipër, dhe të jetë paguar i plotë këstë i tretë i Dividentit 2017 në favor dhe në llogarinë bankare të Shitesit siç përcaktohet në Marrvëshjen Kuadër dhe në pikën 6.1 më poshtë.
- 3.4 Nëse brenda afatit të parashikuar në nenin 3.2 më sipër, Blerësi nuk i paguan Shitesit Çmimin e Kuotës dhe Shoqëria, ku Blerësi ka shumicën, kësttin e tretë të Dividentit 2017, Kontrata do të zgjidhet.
- 3.5 Me qëllim regjistrimin e kësaj Kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), Palet bien dakord dhe pranojnë se do të jetë e mjaftueshme që:
- (a) pronësia e Kuotës AFI Gurabardhi të ketë kaluar në favor të Blerësit;
 - (b) të depozitohet në QKB mandati bankar mandati bankar që vërteton pagesën e shumës së plotë të Dividendit 2017 të papaguar në favor të Shitesit ose një deklaratë me shkrim të Shitesit ku ky i fundit pranon se i është paguar shuma e plotë e Dividendit 2017 të papaguar, dhe
 - (c) të depozitohet në QKB mandati bankar që vërteton pagesën e Çmimit të Kuotës në favor të Shitesit ose një deklaratë me shkrim e Shitesit ku ky i fundit deklaron dhe pranon se i është paguar i gjithë Çmimi.

Neni 4
Deklarime dhe Garanci të Shitesit

- 4.1 Shitesi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar i Kuotës Target dhe të drejtave që rrjedhin prej kësaj Kuote Target.

- 4.2 Shitësi deklaron dhe garanton se bazuar në të gjitha veprimet formale deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Kuota Target është teresisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barre siguruese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve
- 4.3 Shitësi deklaron dhe garanton se, me përbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë kredi ose pretendim, të çfarëdolloj natyre ose titulli, në cilësinë e ortakut ose jo, kundrejt Shoqërisë. Në veçanti, Shitësi deklaron se dividendi eventual i viti financiar që mbylljet në datën 31 dhjetor 2018 ('Dividenti 2018') do t'i takojë ortakëve të tjerë të Shoqërisë (por jo Shitësit), dhe Shitësi nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë të drejtë dhe/ose pretendim te çfarëdolloj natyre ose titulli kundrejt Dividentit 2018 duke hequr dorë shprehimi dha në mënyrë të parevokueshme nga çfarëdolloj të drejtë të lidhur me të.

Neni 5
Deklarime dhe Garanci të Blerësit

- 5.1 Blerësi deklaron shprehimi së Shitës për sa kohë ka qënë (i) e emëruar zyrtarisht në cilësinë e administratores së Shoqërisë dhe/ose (ii) ortake e saj nuk do të jetë subjekt i asnjë përgjegjësie të asnjë lloji, forme apo natyre, kundrejt Shoqërisë dhe/apo ortakëve të saj, apo edhe ortakëve të këtyre të fundit, dhe/apo padi rregull për shkak të detyrimeve kërkuar këtyre të fundit nga palë të treta.

Neni 6
Të ndryshme

- 6.1 Llogaria bankare e Shitësit ku do të bëhen të gjitha pagesat e parashikuara në këtë Kontratë është si më poshtë:

Mbajtës i Llogarisë Bankare: Arta Gurabardhi

Banka: Intesa Sanpaolo Bank Albania

Nr. i Llogarisë Bankare: 41829535102 EUR.

- 6.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në adresat përkatëse të Blerësit dhe të Shitësit, nëpërmjet letrës rekomande me kthim përgjigje ose postës elektronike.
- 6.3 Çdo njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse verifikohen kushtet e mëposhtme: a) nëse është dërguar me postë elektronike, në momentin në të cilin është marrë posta elektronike; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.
- 6.4 Në rast të mungesës të parashikimeve në këtë Kontratë dhe/apo kundërshtie midis klauzolave të Marrëveshjes Kuadër me këtë Kontratë, mbizoterojnë klauzolat përkatëse të Marrëveshjes Kuadër.
- 6.5 Shpenzimet notoriale për lidhjen e Kontratës do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Palëve.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet eskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

**Neni 8
E drejta e zbatueshme**

- 8.1 Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e Palëve do të rregullohen në bazë të legjisacionit shqiptar në fuqi.


**Neni 9
Vlefshmëria – Kopjet origjinale**

- 9.1 Kjo Kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palet. Kjo Kontratë hartohet në 8 (tetë) kopje originale në gjuhën shqipe.

Kjo Kontrate pasi u njoh prej meje Noteres Loriana A. Robo, lu lexua Palëve të cilët e dëgjuan dhe e miratuan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.


Akti nënshkruhet lirisht nga Palët në praninë tare dhe unë Noterja e vertetoj në bazë të ligjit në 8 (tetë) kopje me të njëjtën vlerë ligjore.

SHITËSI



Arta Gurabardhi

BLERËSI



Besnik Leskaj

Blessed Investment SHPK

Besnik Leskaj (Ortak i vetëm)

NOTERI



Loriana A. Robo



TAKSA E PËRQIRË
E PARSTUMËRUE
NOTERI